



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 267, Datë 10.12.2024

MBI

AFATIN E NOMINIMIT NË TREGUN E BALANCIMIT

Në mbështetje të neneve 16, 19, 62, 98, 99 dhe 100 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.12.2024, pasi shqyrtoi relacionin nr. 1549/1_prot., datë 06.12.2024, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike “Mbi kërkesën e OST sh.a. dhe ALPEX sh.a., për ndryshimin e afatit të nominimit në tregun e balancimit ”,

Konstatoi se:

- Bordi i Entit Rregullator të Energjisë me vendimin nr. 106, datë 02.07.2020, vendosi miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”.
- Nëpërmjet shkresës së përbashkët nga OST sh.a dhe ALPEX sh.a, me nr. 3529 prot., datë 21.06.2024 (për OST sh.a) dhe nr. 229 prot., datë 24.06.2024 (për ALPEX sh.a), protokolluar në ERE me nr. 1549 prot., datë 25.06.2024, është kërkuar *ndryshimi i afatit të nominimit në tregun e balancimit.*, e cila synon të ndryshojë afatet për përditësimin e nominimeve, duke e përshtatur atë me praktikat e reja të tregut dhe duke rritur fleksibilitetin operacional.
- Në propozimin e paraqitura nga shoqëritë OST sh.a. dhe ALPEX sh.a., duke marrë në konsideratë përvojën e akumuluar dhe bashkëpunimin me aktorët e tregut, është rekomanduar për përmirësimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit” si dhe është propozuar ndryshimi: *“Nominimet mund të përditësohen brenda ditës, së paku 15 minuta para fillimit të periudhës së lëvrimit”*.
- Ky ndryshim ka për qëllim të përshtatet me zhvillimet teknologjike dhe operationale, duke siguruar një reagim të shpejtë ndaj ndryshimeve të paparashikuara dhe një bashkëpunim më të ngushtë midis platformave të ALPEX sh.a dhe OST sh.a.
- OST sh.a., që nga 1 Prill 2021, kur filloi operimi i tregut të balancimit të energjisë elektrike bazuar në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106/2020, ka zbatuar një interval kohor me rezolucion prej 1 ore për proceset, përfshirë nominimet dhe llogaritjet e disbalancave. Në përputhje me vendimin e bordit të ERE-s nr. 148, datë 25.07.2024, duke filluar nga data 1 Mars 2025, OST sh.a. do të

zbatojë rezolucionin 15-minutësh për këto procese, duke përfshirë nominimet dhe llogaritjet e disbalancave.

- Është thelbësore që operimi i OST-së të harmonizohet me platformën e Bursës Shqiptare të Energjisë (ALPEX), duke siguruar përputhshmëri me rezolucionin orar të përdorur nga ALPEX sipas Vendimit nr. 347, datë 27.12.2022. Ky harmonizim është jetik për përmirësimin e proceseve brenda së njëjtës ditë dhe për qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergetik, përmes koordinimit të ngushtë midis OST-së, ALPEX-it, palëve përgjegjëse për balancimin dhe partnerëve ndërkuftarë.
- Propozimi është publikuar për konsultim në faqen zyrtare të ERE-s dhe deri në këtë vendimmarrje nuk ka marrë komente nga palët e interesuara.
- Për sa më sipër, referuar zhvillimeve të pritshme në Tregun Shqiptar të Energjisë, më konkretisht procesit të Bashkimit të Tregjeve Brenda të Njëjtës Ditë, vlerësohet i arsyeshëm ndryshimi i afatit të nominimeve, pasi është një faktor pengues në zhvillimin e mëtejshëm të këtij procesi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Nryshimin e dipozitës 5.5.1.5 të “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” të miratuara me vendimin e bordit të ERE-s nr.106, date 02.07.2020, si më poshtë vijon:
Është: *“Pasi kontrollohet vlefshmëria e nominimeve të dërguara në D-1 nga PPB tek OST dhe çdo korrigjimi të mundshëm, nominimet e rezervave të marra do t'i nënshtrohen kontrollit të plotë për koherencën ndërmjet kontratave të tjera të shërbimeve ndihmëse të lidhura ndërmjet OST dhe PPB dhe korrigjohen, sipas rastit. Shpeshtësia e këtyre nominimeve është 15 minuta. Nominimet mund të përditësohen brenda ditës, së paku 45 minuta para fillimit të 15 minutave të para të përfshira në përditësim.*
Bëhet: *“Pasi kontrollohet vlefshmëria e nominimeve të dërguara në D-1 nga PPB tek OST dhe çdo korrigjimi të mundshëm, nominimet e rezervave të marra do t'i nënshtrohen kontrollit të plotë për koherencën ndërmjet kontratave të tjera të shërbimeve ndihmëse të lidhura ndërmjet OST dhe PPB dhe korrigjohen, sipas rastit. Shpeshtësia e këtyre nominimeve është 15 minuta. Nominimet mund të përditësohen brenda ditës, së paku 15 minuta para fillimit të periudhës së lëvrimit.*
2. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve, të njoftojë shoqëritë OST sh.a., AlpeX sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI